



14 dhjetor 2015

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Drejtuesit e AKP-së pritën zyrtarët e Elementit Mbështetës Civilo Ushtarak të ShBA-së

Prishtinë – Drejtuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit pritën në një takim zyrtarët e Elementit Mbështetës Civilo Ushtarak (EMCU) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të kryesuar nga udhëheqësi i Ekipit, Peter Preisinger.

Gjatë takimit, (ud) zëvendës drejtori menaxhues i AKP-së, z.Avni Jashari e njoftoi delegacionin nga EMCU për procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë dhe për sfidat që po e përcjellin këtë proces me rëndësi për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

AKP e vlerëson interesimin e mëhershëm dhe vizita e këtij Ekipi në ndërmarrjen Trepça, në jug dhe në veri, ndërsa delegacioni nga EMCU shprehu falënderime për aranzhimin e vizitave të sipërpërmendura si dhe vlerësoi rëndësinë strategjike në zhvillimin e ndërmarrjes Trepça.

FUND